



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**  
***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 28.1.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Salih Zyba, Etem Arifi dhe Danush Ademi.

Munguan: Salih Salihu, Ganimete Musliu, Liburn Aliu, dhe Sërgjan Mitrovic.

Të ftuar: Raif Preteni, drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) dhe Bekim Juniku, zv.drejtor i Shoqatës së ujësjellësve dhe kanalizimit të Kosovës (SHUKOS).

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

*Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:*

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 23.1.2019;
3. Shqyrtimi i draft Planit të punës së Komisionit për vitin 2019;
4. Shqyrtimi për lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;
5. Të ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja 23.1.2018**

*Kryetari Nitaj*, konstatoi se Komisioni me 6 vota për, një abstenim, miratoi procesverbalin nga mbledhja 23.1.2018, me plotësimin e dhënë nga zv.kryetarja Besa Gaxherri.

### **3. Shqyrtimi i draft Planit të punës së Komisionit për vitin 2019;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, tha se në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për planin e punës, por kërkuam që miratimi i tij të shtyhet dhe të priten idetë dhe propozimet e anëtarve të komisionit, dhe konstatoi se nuk ka ardhë asnjë propozim, mirëpo shtoi se këtë plan edhe pas miratimit e konsideroj të ndryshueshëm dhe ai mund të ndryshojë sipas nevojave dhe prioriteteve të Komisionit, dhe e hapi debatin.

**Salih Zyba**, pyeti a mundet komisioni, me kërku prej Qeverisë apo me rekomandu ndryshimin siq kishte kërku në mbledhjen e kaluar për ç'vendosje të agjendës legjislative psh. për Projektligjin për farëra i planifikuar të procedohet në dhjetor, të kërkohet të vijë më herët pra në këtë sezonë para mbjelljeve, për shkak të rëndësisë që ka dhe pasi që është thënë nga ministria se ligji është i gatshëm.

**Besa Gaxherri**, tha se është e vërtetë se Qeveria e ka agjendën e vet të ligjeve, por në qoftë se ne si komision pajtohemi se një ligj i rëndësishëm e që Qeveria për shkaqe të caktuara e vonon, ne mundemi me marrë vetëiniciativë për me përgatitë ligjin ose me kërku prej Qeverisë me përsheptu.

**Muharrem Nitaj**, tha se nuk besoj se ne mund të ndikojmë shumë në agjendën e ligjeve që vijnë nga Qeveria, por ne mund të kërkojmë që koha e procedimit të tyre të shpejtohet, psh Projektligji për farëra, ndërsa agjenda e punëve të komisionit mund të ndryshojë në çdo kohë duke përfshirë edhe monitorimin e ligjeve që Komisioni do ti përzgjedhë se cilat ligje do ti monitorojë dhe do ta plotësojë planin.

*Në fund të diskutimeve, Kryetari Nitaj, ftoi deputetët për votim dhe Komisioni me 7 vota për, asnjë kundër dhe abstenim, nxori këtë:*

#### ***Përfundim***

*Miratohet Plani i punës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, për vitin 2019.*

### **5. Shqyrtimi për lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, tha se komisioni e ka miratuar një amendament dhe e ka dërguar te komisionet e përherëshme, duke menduar se është gjetë një kompromis, mirëpo kemi pasë disa pakënaqësi nga kompanitë e ujësjellësve dhe e kemi rihapë këtë temë në komision. I kemi ftuar z. Raif Preteni, drejtor i ARRU-së dhe z. Bekim Juniku, zv.drejtor i SHUKOS, të dëgjojmë prej tyre propozimin se cila mund të jetë zgjidhja.

**Raif Preteni**, drejtor i ARRU-së, tha se jemi para dy dilemave, se a duhet të lirohen apo jo objektet e kultit nga pagesa dhe shtoi se në shumë shtete rreth Kosovës, si në Shqipëri, Mal të Zi si dhe në shtete të BE-së, deri tash nuk kemi hasë në asnjë rast që, objektet e kultit lirohen nga pagesa, por ato faturohen si objekte institucionale. Prandaj edhe propozimin që e kemi dhënë në projektligj, ka qenë për me ju ndihmu objekteve fetare që të faturohen si konsumatorë shtëpiak, që i bie tarifë përgjysmë më e ulët. Ndërsa për amendamentin kërkoi që në vend të fjalës “*industrialë*” të përdoret “*institucional*”, për shkak se janë tarifa institucionale e jo industriale. Në vazhdim ai tha se ka pasë keqpërdorime, sepse i kanë hjekë ujëmatësit dhe është përdorë uji për me vaditë siq janë: kisha në Pejë, pastaj disa xhami, ato vaditin arat dhe ata thonë se lidhjen e kanë prej objektit.

Keqpërdorime të ujit ka patur, tha edhe **Bekim Juniku nga SHUKOS-si**, si shembull e mori KRU Gjakova gjatë vitit 2015, 2016, janë faturuar 5931 m kub ujë, në momentin kur është marrë vendimi për me i falë janë hjekë ujëmatësit ka ndodhë një keqpërdorim enorm. Ndërsa në vitin 2016-2017 është faturuar 10539 m kub ujë pra rritje 100% dhe është bërë keqpërdorim enorm.

**Salih Zyba**, pajtohem tha të shmanget fjala industrialë në rastet kur nuk është i tillë por kur është industrialë psh ai mund të jetë prodhues i ujit apo i lëngjeve këtu do të duhej të ekziston tarifa

industriale. Ndërsa shtroi pyetjen se kush i bartë përgjegjësitë qeveria, komuna apo ndërmarrja, nuk ishit konkret, në rast të lirimit nga pagesa. Rezervat e ujit janë aset shtetëror, ndërsa përpunimi dhe shpërndarja lidhen me ndërmarrjen, pajtohem që objektet e kultit të faturohen me tarifën minimale të konsumatorëve shtëpiake, ndërsa me qenë se është burim natyror Qeveria nëse do, mundet me nxjerrë aktet e tjera për me i liru si kategori.

**Andin Hoti**, tha se fjala “industrial” ka të bëjë vetëm me tarifën ndërsa për objektet që janë jashtë kultit të faturohen si objekte biznesi, ky ka qenë qëllimi i përdorimit të këtij termi. E përsëriti propozimin nga mbledhja e kaluar, që nëse lirohen këto objekte të kultit, të kenë një numër të caktuar të kubikëve të ujit që u nevojitet për nevojat e tyre dhe këtë ta paguajë Qeveria, ndërsa pjesa tjetër e shpenzuar të faturohet si konsumatorë shtëpiake dhe kështu mundësia e keqpërdorimit është shumë më e vogël. Për këtë ai propozoi që të thirren përfaqësuesit e BIK-ut dhe kompanitë e ujesjellesve që ta përcaktojnë këtë.

**Besa Gaxherri**, edhe ndryshimi i ligjit ka pasë të bëjë me faturimin dhe kontrollin e shpenzimit të ujit dhe pasi që u tha se asnjë shtet në Evropë dhe regjion nuk e falë ujin e shpenzuar nga objektet e kultit dhe nuk mendoj se edhe ne duhet me ju falë. Nuk është e arsyeshme me i liru, sepse janë shumë objekte të kultit dhe ato tash më janë të konsoliduara, ndërsa kemi shumë familje të varfëra që nuk kanë mundësi me u kyqë në ujesjellës apo me i pagu. Në fund ajo pyeti, nëse lirohen nga pagesa, kujt i faturohet ky ujë i shpenzuar apo kush e kompenzon.

**Danush Ademi**, tha se objektet e kultit kishat dhe xhamitë dallojnë në mes vete sa i përket shpenzimit të ujit, xhamitë nuk e keqpërdorin ujin, ai përdoret për abdes, pastrimin i kufomave dhe është mirë të definohen këto gjëra më mirë dhe se Kompania duhet të vendosë ujëmatësit në secilin objekt të kultit.

**Etem Arifi**, objektet e kultit është e mjaftueshme me i kategorizu në konsumatorë shtëpikë dhe nuk duhet me i u dhënë mundësi me keqpërdorë ujin askujt. Nëse lirohet nga pagesa ne do ti hapim rrugën për me u keqpërdorë.

**Muharrem Nitaj**, tha se ne jemi të interesuar ta zgjidhim këtë problem, e jo të hapim derën për keqpërdorime të ujit dhe shtroi një pyetje: nëse një objekt i kultit duhet me u liru prej pagesës, pse nuk duhet me u liru një qerdhe apo shtëpi e pleqve. Prandaj e përkrahu variantin e projektligjit me një ndryshim që objektet përcjellëse fitimprurëse të mos faturohen në tarifën “industrial” por në atë “institucional” që është tarifë më e lirë.

*Në fund të diskutimeve kryetari Nitaj, e lexoi propozimin dhe i ftoi deputetët për votim, konstatoi se Komisioni me 6 vota për dhe 1 abstenim, miratoi amendamentin dhe Raporti plotësues i dërgohet komisioneve të përhershme.*

## **Amendamenti 1**

*Neni 4, paragrafi 2, ndryshohet si në vijim:*

*2. Në nenin 20 të ligjit bazik, paragrafi 5, ndryshohet si në vijim:*

***5. Objektet e kultit dhe objektet përcjellëse administrative, faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiake, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë-institucional.***

## **6. Të ndryshme**

**Salih Zyba**, paraqiti një qështje si shqetësim nga marketet për barkodet e disa prodhimeve në shitje, si miell, qumësht, higjienike, etj të cilat i përmendi se ato kanë barkodin e Kosovës ndërsa janë prodhime të vendeve të tjera, siç Serbisë, Bosnjës, etj. Propozoi që komisioni të vizitojë Odën Ekonomike të Kosovës në lidhje me këtë temë pastaj edhe AUV-in. Komisioni u pajtua që nesër dy deputetët: Salih Zyba dhe Andin Hoti të vizitojnë Odën Ekonomike të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetari i Komisionit,

**Muharrem Nitaj**